Vjoftuar me email

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr.3073/6 Prot. Vlorë më, 04.11.2026

VENDIM

Nr.66, datë 04.11.2026

PËR
ÇELJEN E PROCEDURAVE DHE PËRCAKTIMIN E AFATEVE TË APLIKIMIT PËR ANËTAR NË BORDIN E ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË, NË CILËSINË E PËRFAQËSUESËVE TË UNIVERSITETIT

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja "gj", dhe nenit 48 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 19, pika 1, shkronja "ll", nenit 23 dhe nenit 24 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 04.11.2026,

VENDOSI:

1. Të shpallë procedurën dhe afatet për përzgjedhjen e **3 (tre) anëtarëve** të Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, përfaqësues të Universitetit.
2. Kjo procedurë të respektojë fazat dhe afatet e mëposhtme:

   a) Afati i dorëzimit të dokumenteve për aplikim si kandidat për anëtar në Bordin e Administrimit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, përfaqësues të universitetit do të jetë nga data **04.11.2026** deri më datë **11.11.2026**.
   b) Afati i dorëzimit të dokumenteve nga njësitë bazë për të bërë propozimet për anëtar në Bordin e Administrimit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, përfaqësues të universitetit do të jetë nga data **04.11.2026** deri më datë **11.11.2026**.
   c) Sekretari i SA tërheq, me procesverbal nga Sektori i Protokoll-Arkivës, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit dhe ia përcjell për shqyrtim Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, i cili ngrihet me vendim të Senatit Akademik.
   d) Emri i anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të institucionit, përcillet në MA.

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Ëeb-site: ëëë.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

3. Individët dorëzojnë kërkesën për kandidaturën e tyre me shkrim pranë Sektorit të Protokoll-Arkivës, e cila duhet të përmbajë këto të dhëna dhe dokumente shoqëruese:

a) Emri, mbiemri dhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni dhe adresë e-mail);
b) Statusi si personel akademik me kohë të plotë pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (i vërtetuar me dokument përkatës);
c) Titulli akademik ("Profesor", "Profesor i Asociuar") ose grada shkencore "Doktor", të shoqëruara me dokumentacionin përkatës që vërteton fitimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi;
d) Njësia kryesore ku ushtron aktivitetin akademik (fakulteti/departamenti);
e) Deklaratë e nënshkruar që nuk ushtron funksione drejtuese në njësitë kryesore dhe bazë të Universitetit;

4. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

a) Të jenë personel akademik me kohë të plotë pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë;
b) Të zotërojnë titullin akademik "Profesor", "Profesor i Asociuar", ose gradën shkencore "Doktor", të fituar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
c) Të mos jenë në pozicione drejtuese të njësive kryesore të UV-së;
d) Të mos jenë drejtues të njësive bazë të institucionit;
e) Të mos ushtrojnë funksionin e Rektorit ose Administratorit pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë;
f) Të përmbushin kriteret e parashikuara në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Drejtuesit e njësive kryesore, Drejtuesit e njësive bazë dhe Drejtoria e shërbimeve Ndihmësakademike në UV.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

NËN KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Asoc . Denada Sota

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË